

I nderuar z. Çika,

Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për informim, në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, në lidhje me verifikimin e për dhënien e kthimit të përgjigjeve për praktikat/kërkesat e shtetasve apo të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në shkallë vendi, mbi vendin e vuajtjes së dënimit apo të internimit, është regjistruar me nr.813 prot, datë 04.06.2021.

Në kuadër të ligjit nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”* (Ndryshuar me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020), sipas të cilit janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, dhe vënien në dispozicion të institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore, të informacioneve të domosdoshme për qëllimet e parashikuara në këtë ligj, në bashkëpunim me autoritetet e tjera publike dhe arkivat, për vënien në dispozicion, për qëllimet e kërkuara në të zbatimit të këtij ligji, duke mbajtur parasysh, njohur dhe përdorur dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RPSSH, për periudhën e parashikuar në ligj dhe fushë veprimin e tij, që kanë të bëjnë me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, të ndryshuar. Për zgjidhjen e këtyre praktikave është operuar me një praktikë, rregullim dhe afate të përcaktuara.

Në përmushje të sa më sipër kemi ndeshur në disa problematika në lidhje me dokumentacionin e mangët në lidhje me vendin dhe dinamikën e vuajtjes së dënimit dhe llojin e punës që është kryer, për periudhën e burgimit në Spaç dhe Qafë Bari. Vështirësia për Autoritetin qëndron në faktin se nuk rezulton të evidentohet me dosjet hetimore dhe gjyqësore, pasi nuk gjenden në arkivën e institucionit (Drejtoria e Arkivit), pranë Autoritetit, dokumente të tilla si dosja e të dënuarit apo fleta e lirit për subjektin aplikues.

Për të eliminuar vështirësitë e krijuara dhe problematikën e ndeshura për shkak të mangësive në dokumentacion, që kryesisht nuk gjëndet në fondin tonë arkivor, pasi nuk ka qenë detyrë funksionale e ish - Sigurimit të Shtetit, por e policisë së kampe burgjeve, për të cilat kanë ekzistuar dosje të të dënuarit, problematikë kjo edhe për evidencat e të internuarve.

Për këtë arsye kemi komunikuar në vazhdimësi me insitucione të tjera, kemi ardhur në dijeni se një pjesë të këtij dokumentacioni që kishte të bënte me kampe - burgjet, ndodhen pranë arkivit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nga të cilët kemi kërkuar vënien në dispozicion për qëllime shërbimi ndaj kërkuësve të dokumentacionit dublikatë që disponohet nga ana e tyre.

Konkretisht pas disa takimeve dhe konsultimeve të përbashkëta institucioni ynë i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresën Nr.865 Prot, datë 11.08.2020, *“Kërkesë për vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore”*, bazuar dhe në zbatim të ligjit 45/2015 *“Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, referuar nenit 13, pika 4 sipas së cilit *“Kur autoriteti publik ose arkivi merr një kërkesë, sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij neni, i përgjigjet Autoritetit, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duke i vënë në dispozicion, sipas rastit, dokumentet ose kopje apo dublikata të tyre.”*, nenit 14, pika 1, sipas së cilit *“Çdo autoritet publik dhe arkiv, me kërkesën e Autoritetit, i dorëzon atij dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që gjenden pranë tyre, duke përfshirë kopjet dhe dublikata të tjera”*, nenit 17, pika 1, sipas së cilit *“Kur për dokumentet që u përkasin autoriteteve publike nuk ka të dhëna se krijimi i tyre është nxitur apo urdhëruar nga ish-Sigurimi i Shtetit, Autoriteti i rikthen ato, me kërkesë të autoriteteve publike apo kryesisht kur*

konstaton sa më sipër. Autoriteti mund të mbajë kopje ose publikata të këtyre dokumenteve”, duke kërkuar të na vihen në dispozicion dokumentet ish-Sigurimi i Shtetit, përfshirë dokumente të krijuara, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, të cilat ruhen dhe administrohen pranë arkivit apo kartotekës së institucioni tuaj.”

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën Nr.8306 Prot, datë 26.10.2020, në trajtë CD na ka vendosur në dispozicion, dokumentacionin publikatë, regjistrat e të dënuarve politikë nga viti 1947 – 1991.

Autoriteti për të rregulluar këtë problematikë, dhe formalizuar atë, ka konkluduar me vendimin nr. 630, datë 20.11.2020, duke vendosur; dhënien e informacionit për kërkuesit / shtetasit, ose dhënie publikatë të dokumentit që gjendet në regjistrin e vuajtjes së dënimit që disponon, pasi dokumentet origjinale gjenden tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Mbas vendimit të mësipërm, në Autoritet puna ka vazhduar normalisht për kthimin e përgjigjeve të kërkesave të dorëzuara nga shtetasit dhe nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve në shkallë vendi, deri në momentin kur është shfaqur një problematikë e re në lidhje me këto kërkesa të paraqitura në Autoritet, mbi një sugjerim (diskutim), nëse për shqyrtimin e këtyre kërkesave të paraqitura në Autoritet duhet të bazohemi vetëm në dokumente që ndodhen në arkivin e saj (dokumente të ish - Sigurimit të Shtetit) vetëm sipas përcaktimeve të ligjit 45/2015. Këto problematika ishin shqyrtuar e duke kryer një punë voluminoze në marrveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, nga e cila na ishin vendosur në rrugë zyrtare, në dispozicion regjistrat përkatës të cilët po shfrytëzoheshin nga specialist përkatës me dijeninë dhe dakortësinë e anëtarëve në zbatim të vendimit nr. 630, datë 20.11.2020.

Është fakt që, procesi për dhënien e kthimit të përgjigjeve për praktikat/kërkesat e shtetasve apo të Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në shkallë vendi, të dorëzuara në Autoritet, është pezulluar perkohësisht, deri në marrjen dhe mbajtjen e një qëndrim për këtë çështje, problem që tashmë është tejkaluar dhe po vazhdon normalisht.

Nga ana e drejtuesve të institucionit është vlerësuar dhe janë marrë masat e duhura, njëherazi urdhëruar vazhdimi i këtij shërbimi për sa kohë vendimi nr. 630, datë 20.11.2020 është në fuqi dhe jashtë çdo afati ligjor për rishikimin e tij.

Sa i takon vlerësimeve mbi “bindje” i konsiderojmë jashtë etikës dhe nuk shërbejnë në zgjidhjen e çështjes, natyrisht as në bashkpunimin tonë efektiv si dhe deri më tani. Ne jemi dhe veprojmë si një institucion i pavarur dhe i depolitizuar.

Duke ju falenderuar

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë AIDSSH
Selami Zalli**

E-MAIL: selami.zalli@autoritetidosjeve.gov.al

*Selami Zalli
Drejtor
Drejtoria e Informacionit*

*Autoriteti Për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit
Adresa: Garda e Republikës, Rr.Ibrahim Rugova, Tirane*

http: www.autoritetidosjev.gov.al